

LIGJ
Nr. 8081, datë 7.3.1996

PËR VEPRIMTARITË E SIGURIMIT DHE TË RISIGURIMIT
(Ndryshuar me ligjet; nr. 8458, datë 11.2.1999; nr. 8606, datë 27.4.2000; nr. 8278, datë 18.1.2001)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti i ligjit

Ky ligj përcakton parimet dhe rregullat e përgjithshme lidhur me sipërmarrjet në sigurime dhe pikërisht ato që kanë të bëjnë:

a) Me ushtrimin e veprimtarive të sigurimeve të drejtpërdrejta të cilat kanë për objekt grupet e sigurimeve për jetën ose grupet e sigurimeve të tjera të quajtura më poshtë sigurime për dëme, që parashikohen në shtojcën e këtij ligji.

b) Me ushtrimin e veprimtarive që kanë për objekt risigurimet.

c) Me mbikëqyrjen nga ana e shtetit të shoqërive dhe enteve ligjore të tjera që marrin përsipër e ushtrojnë një veprimtari sigurimi dhe/ose risigurimi.

Neni 2
Përkufizime

Për qëllime të këtij ligji:

a) "Shoqëri" do të thotë një shoqëri tregtare apo një ent ligjor tjetër që ushtron veprimtari sigurimi ose risigurimi, të natyrës së parashikuar në këtë ligj.

b) "Degë" do të thotë një degë, një agjenci ose një përfaqësi e vendosur në territorin e Republikës së Shqipërisë nga një shoqëri e huaj, nëpërmjet së cilës kjo e fundit ushtron veprimtari sigurimi dhe/ose risigurimi.

c) "Përgjegjësi" do të thotë përgjegjësia financiare e shoqërisë ndaj të sigurvearit ose të risigurimit për mbulimin e rrezikut të marrë përsipër sipas kushteve të përcaktuara në kontratë.

d) "Rezervë teknike" do të thotë një shumë e llogaritur në bazë të një parashikimi dhe sipas mënyrave të caktuara, e cila ruhet në llogaritë e shoqërisë për të mbuluar përgjegjësitë financiare.

Neni 3
Fusha e zbatimit të ligjit

Ky ligj është i zbatueshëm për sipërmarrjet në sigurime dhe në risigurime nga shoqëritë vendase dhe të huaja, të cilat marrin përgjegjësi për mbulimin e rreziqeve në bazë të kontratave të lidhura, përkatësisht, me të siguruarit dhe të risiguruarit.

Ky ligj nuk u përket:

- Institutit të Sigurimeve Shoqërore
- Institutit të Sigurimit të Kujdesit Shëndetësor
- Shoqërive, shoqatave dhe enteve të tjera që bëjnë pjesë në një regjim sigurimesh, kapitalizimesh, ndihmash apo përkrahjeje shoqërore, mbikëqyrja e të cilave rregullohet me ligje të posaçme.

Neni 4

Shoqëritë - forma juridike

Për të ushtruar një veprimtari sigurimi të natyrës së parashikuar në nenin 1, shkronja "a", të këtij ligji, si dhe për të ushtruar një veprimtari risigurimi shoqëria vendase duhet të jetë themeluar në formën e shoqërisë anonime.

Një shoqëri e huaj mund të ushtrojë, duke u nisur nga territori i Republikës së Shqipërisë, një veprimtari sigurimi dhe/ose risigurimi në qoftë se përmbush kushtet e legjislacionit të shtetit të origjinës. Shoqëria e huaj mund të ushtrojë veprimtari sigurimi dhe risigurimi, duke u nisur nga territori i Republikës së Shqipërisë, vetëm nëpërmjet degës së saj të vendosur në këtë territor.

Neni 5

Kufizimi i objektit të shoqërisë

Shoqëria vendase apo dega e shoqërisë së huaj duhet ta kufizojë objektin e saj vetëm në veprimtarinë e sigurimit dhe të risigurimit, si dhe në operacionet që rrjedhin drejtpërdrejt nga kjo veprimtari, duke përjashtuar çdo veprimtari tregtare tjetër.

Neni 6

Ushtrimi nga e njëjta shoqëri e sigurimeve për jetën dhe sigurimeve për dëmet

Shoqëria që kryen sigurime për jetën nuk mund të kryejë sigurime për dëme dhe anasjelltas.

Neni 7

Sigurimet e drejtpërdrejta jashtë rreziqeve që gjenden në Republikën e Shqipërisë

Nuk lejohet nënshkrimi i një sigurimi të drejtpërdrejtë pranë një shoqërie të huaj të vendosur në një shtet tjetër, për një rrezik që i përket një personi, një sendi ose një përgjegjësie që gjendet në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Megjithatë, dispozita e paragrafit të mësipërm nuk është e zbatueshme për sigurimin e rreziqeve të lidhura me transportin detar ose ajror.

Ministri i Financave mundet, në shmangie të dispozitës së paragrafit të parë të këtij neni, të autorizojë sigurime të drejtpërdrejta jashtë në rastet kur mbulimi i një rreziku nuk mund të merret përsipër nga shoqëritë vendase apo degët e shoqërive të huaja të vendosura në Republikën e Shqipërisë.

Neni 8

Pranimet në risigurim nga shoqëria e sigurimit

Shoqëritë e sigurimit mund të kryejnë pranime në risigurime të përgjegjësive të marra nga një shoqëri tjetër sigurimesh, në bazë të marrëveshjeve të lidhura për këtë qëllim.

Shoqëria e sigurimit pranuese emërtohet shoqëri sigurimi-risigurim.

Neni 9

Risigurimet - përgjegjësia e siguruesit

Shoqëria e sigurimit mund t'i japë një shoqërie risigurimesh apo sigurim-risigurimesh pjesë të përgjegjësive që ka kontaktuar me të siguruarit sipas marrëveshjeve të lidhura për këtë qëllim.

Risigurimet mund të kryhen qoftë te shoqëritë vendase ose te degët e shoqërive të huaja të krijuara në Republikën e Shqipërisë, qoftë te shoqëritë e huaja që nuk kanë degë në Republikën e Shqipërisë.

Në të gjitha rastet kur shoqëria e sigurimit risigurohet kundër rreziqeve që ka siguruar, ajo mbetet përgjegjëse e vetme ndaj të siguruarve, nënshkrues apo përfitues të kontratave të sigurimit.

Neni 10

Ndërmjetësimi

Ndërmejtësimet në sigurime dhe në risigurime kryhen nga persona juridikë ose fizikë të autorizuar.

Kushtet e dhënies së autorizimit, si dhe rregullat për ndërmjetësimet në sigurime dhe në risigurime caktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 11

Klauzolat tipike në kontratat e sigurimeve

Ministri i Financave mund t'u imponojë shoqërive të sigurimit përdorimin e klauzolave-tip në kontratat e sigurimeve dhe, për kontratat e sigurimit të jetës, mund të caktojë rregulla të llogaritjeve aktuariale që duhet të zbatohen.

Neni 12

Tarifat e primeve për sigurimet

Tarifat e primeve të sigurimit caktohen nga vetë shoqëria e sigurimit, me përjashtim të primeve për sigurimet e detyrueshme të pasurisë ose përgjegjësive, që rregullohen me ligj të veçantë.

Shoqërive të sigurimit nuk mund t'u vihen detyrime që parashikojnë miratimin paraprak të tarifave të primeve të propozuara prej tyre dhe as miratimin paraprak të rritjes së tarifave. Atyre nuk mund t'u kërkohej paraqitja paraprake e tarifave të primeve vetëm si pjesë e sistemit të përgjithshëm të kontrollit mbi çmimet.

Neni 13

Kontrolli i dokumenteve të sigurimit

Komisioni i Mbikëqyrjes së Sigurimeve mund të kërkojë paraqitjen përpara përdorimit

të çdo dokumenti kontraktor ose me karakter publiciteti që ka për objekt një operacion sigurimi.

Në një afat prej një muaji nga data e paraqitjes së dokumentit Komisioni i Mbikëqyrjes mund të urdhërojë ndryshimin e tij. Në mbarim të këtij afati dokumenti mund të shpërndahet në publik.

Në qoftë se zbulohet se një dokument i vënë në qarkullim është në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe nënligjore në fuqi, Komisioni i Mbikëqyrjes mund të vendosë tërheqjen e dokumentit nga qarkullimi ose të kërkojë riformimin e tij.

Neni 14

Kontributet e shoqërive

(Ndryshuar paragrafi i dytë me ligjin nr. 8458, datë 11.2.1999)

Shpenzimet e çdo natyre për zbatimin e dispozitave të këtij ligji lidhur me mbikëqyrjen e shtetit në fushën e sigurimeve përballohen nëpërmjet kontributeve të shoqërive të sigurimit dhe/ose të risigurimit.

Këto kontribute caktohen çdo vit dhe për çdo shoqëri nga Ministri i Financave, në përpjesëtim me shumën e primeve ose të kuotave të fituara, por nuk mund të jenë më shumë se 0.005 (pesë të mijtat) e shumës së këtyre primeve apo kuotave.

Neni 15

Krijimi i Byrosë Motorike

(Shfuqizuar me ligjin nr. 8278, datë 18.1.2001)

Neni 16

Bashkimi dhe shoqata

Shoqëritë e sigurimit dhe/ose të risigurimit mund të bashkohen në shoqata kombëtare profesionale, si dhe të bëhen anëtare të shoqatave ndërkombëtare të kësaj natyre.

Neni 17

Autorizimi zyrtar - sigurimet

Për të hyrë në një veprimtari sigurimi të drejtpërdrejtë shoqëria e sigurimit, vendase apo e huaj, duhet të marrë më parë një autorizim zyrtar.

Ky autorizim jepet nga Komisioni i Mbikëqyrjes së Sigurimeve, sipas kushteve të caktuara në seksionin e dytë të kreut të dytë të këtij ligji.

Shoqëria nuk mund të kryejë veçse operacionet e sigurimit për të cilat është e autorizuar.

Shoqëria e sigurimit mund të nënshkruajë kontrata sigurimi për llogari të një shoqërie tjetër të autorizuar sipas një marrëveshjeje të lidhur për këtë qëllim.

Neni 18

Autorizimi zyrtar - risigurimet

Shoqëritë që kanë për objekt vetëm operacionet e risigurimit mund të nisin veprimtarinë e tyre pasi të kenë marrë një autorizim zyrtar nga Komisioni i Mbikëqyrjes së Sigurimeve.

Autorizimi i parashikuar në paragrafin e parë nuk kërkohet për shoqëritë e huaja, që nuk kanë degë në Republikën e Shqipërisë dhe që kryejnë risigurime duke u nisur nga selia e tyre në shtetin ku ndodhen.

Neni 19
Kriteret e dhënies së autorizimit

Për dhënien ose mosdhënien e autorizimit zyrtar Komisioni i Mbikëqyrjes së Sigurimeve merr parasysh:

- mjetet teknike dhe financiare që shoqëria e interesuar propozon të vërë në përdorim dhe përputhjen e këtyre mjeteve me programin e veprimtarisë;
- besueshmërinë dhe kualifikimin teknik të personave të ngarkuar për të drejtuar e administruar shoqërinë;
- shpërndarjen e kapitalit të shoqërisë.

Neni 20
Objekti dhe shtrirja e mbikëqyrjes

Mbikëqyrja e parashikuar në këtë ligj ushtrohet me qëllim të mbrojtjes së interesave të të siguarve, nënshkrues dhe përfitues të sigurimit.

Kjo mbikëqyrje shtrihet sidomos mbi gjendjen financiare të shoqërive të sigurimit, duke përfshirë aftësinë paguese, krijimin e rezervave teknike dhe mbulimin e këtyre rezervave me aktive, të mjaftueshme dhe të shpërndara në një mënyrë të përshtatshme.

KREU II
DISPOZITAT PËR SHOQËRITË VENDASE

SEKSIONI I
THEMELIMI DHE FUNKSIONIMI

Neni 21
Kushtet e zbatimit të dispozitave të ligjit "Për shoqëritë tregtare"

Shoqëritë anonime të sigurimit dhe/ose të risigurimit themelohen dhe funksionojnë në pajtim me dispozitat e ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare", si dhe me dispozitat e këtij seksioni.

Neni 22
Kushtet e zbatimit të ligjit "Për Institutin e Sigurimeve"

Instituti i Sigurimeve (INSIG) i themeluar në bazë të ligjit nr.7461, datë 23.7.1991 do të adaptojë formën e shoqërisë anonime shtetërore dhe do të funksionojë në pajtim me dispozitat përkatëse të ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare", si dhe me dispozitat e këtij seksioni.

Instituti i Sigurimeve e ushtron veprimtarinë e vet në kushte të njëjta me shoqëritë e sigurimeve të së drejtës private.

Neni 23
Kapitali themeltar - shuma
(Ndryshuar me ligjin nr. 8606, datë 27.4.2000)

Shoqëritë e sigurimit dhe/ose të risigurimit duhet të kenë një kapital themeltar, pa përfshirë kontributet në natyrë, jo më të vogël se shumatat e përcaktuara sipas grupeve të sigurimit:

a) 100 milionë lekë, nëse shoqëria ushtron veprimtarinë në një ose më shumë prej grupeve 10 deri në 15 (përfshirë grupin 15) të shtojcës së këtij ligji;

b) 60 milionë lekë, nëse shoqëria ushtron veprimtarinë në një ose më shumë prej grupeve 1 deri në 8 (përfshirë grupin 8) dhe 16 e 18 të shtojcës së këtij ligji;

c) 50 milionë lekë, nëse shoqëria ushtron veprimtarinë në një ose më shumë prej grupeve 9 dhe/ose 17 të shtojcës së këtij ligji;

ç) 120 milionë lekë, nëse shoqëria ushtron veprimtarinë për sigurimin e jetës në një ose më shumë prej grupeve 19 deri 22 (përfshirë grupin 22).

Kapitali themeltar i shoqërisë së sigurimit duhet të përbëhet, të paktën në dy të tretat e tij, prej mjeteve monetare. Çdo aksioner duhet të derdhë për llogari të shoqërisë, në krijim e sipër, në njërën nga bankat tregtare të nivelit të dytë që ushtrojnë veprimtarinë në Republikën e Shqipërisë, në mjete monetare jo më pak se gjysmën e kontributit të nënshkruar prej tij.

Neni 23/1

(Shtuar me ligjin nr. 8606, datë 27.4.2000)

Shoqëritë, të cilat janë pajisur me autorizim zyrtar për ushtrimin e veprimtarisë siguruese dhe/ose risiguruese, brenda tre viteve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, duhet të arrijnë kufijtë e kapitalit themeltar, të përcaktuar në nenin 23, si vijon:

a) 50 milionë lekë në fund të vitit të parë;

b) 60 milionë lekë në fund të vitit të dytë;

c) 100 milionë lekë në fund të vitit të tretë.

Neni 24

Ndryshimet e statutit

Shoqëritë e sigurimit dhe/ose të risigurimit përpara se t'i shtrojnë Asamblesë së Përgjithshme ndryshimet e statutit të tyre duhet të marrin miratimin e Komisionit të Mbikëqyrjes së Sigurimeve. Komisioni duhet të vendosë brenda tre muajve nga data e depozitimit të projektit të vendimit për ndryshimet e statutit. Në qoftë se në mbarim të këtij afati Komisioni i Mbikëqyrjes nuk ka bërë vërejtje, ndryshimet e statutit quhen të miratuara. Ky afat zbret në dyzet e pesë ditë për zmadhimin e kapitalit.

Neni 25

Ndryshimi i titullarit

Shoqëritë e sigurimit dhe/ose të risigurimit duhet t'i bëjnë të ditur Komisionit të Mbikëqyrjes së Sigurimeve çdo ndryshim të titullarit që i përket funksionit të presidentit, drejtorit të përgjithshëm ose drejtorit.

Neni 26

Përfshirja nga detyrimi për rezervën e domosdoshme

Shoqëritë anonime të sigurimit dhe/ose të risigurimit përfshihen nga detyrimi i krijimit të rezervës së domosdoshme të parashikuar nga neni 213 i ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare".

Neni 27

Pjesëmarrja në shoqëritë anonime

Shoqëria e sigurimit dhe/ose e risigurimit duhet t'i bëjë të ditur Komisionit të Mbikëqyrjes së Sigurimeve përpara kryerjes së çdo operacion shetje të aksioneve një aksioneri, person fizik ose juridik, që i jep këtij të fundit, drejtpërdrejt ose tërthorazi, një pjesëmarrje që arrin më shumë se një të njëzetën, një të dhjetën, një të pestën, një të tretën, një të dytën ose dy të tretat e kapitalit themeltar apo të drejtave të votës.

I njëjti informim bëhet edhe kur pjesëmarrja në kapital ose në të drejtat e votës bëhet më e vogël se vlerat kufitare të parashikuara në paragrafin e mësipërm.

Në qoftë se shoqëria është bërë objekt i njëres nga masat e parashikuara në nenin 49 të këtij ligji, operacioni i shitjes mund të kryhet vetëm me autorizim të Komisionit të Mbikëqyrjes së Sigurimeve.

Çdo person fizik ose juridik që propozon të blejë direkt ose indirekt një masë aksionesh, që arrin ose tejkalon 20 për qind të aksioneve të shoqërisë ose të të drejtave votuese, duhet të njoftojë Komisionin e Mbikëqyrjes së Sigurimeve duke treguar edhe masën e pjesëmarrjes.

Brenda tre muajve nga data e njoftimit Komisioni i Mbikëqyrjes së Sigurimeve duhet të kundërshtojë propozimin e bërë në qoftë se, nga pikëpamja e nevojës për të siguruar një drejtim të kujdesshëm e të qëndrueshëm të shoqërisë, ai nuk është i kënaqur përsa i përket kualifikimit të personit të përmendur në paragrafin e katërt.

Në qoftë se propozimi nuk kundërshtohet, atëherë duhet të caktohet koha maksimale për zbatimin e tij.

Neni 28

Pjesëmarrja e huaj

(Shfuqizuar paragrafi i dytë me ligjin nr. 8606, datë 27.4.2000)

Personat e huaj, fizikë apo juridikë, mund të marrin pjesë në themelimin e shoqërive vendase të sigurimit dhe/ose të risigurimit ose të blejnë aksione të këtyre shoqërive.

Dispozitat e nenit 27 janë të zbatueshme edhe për personat e huaj.

SEKSIONI II

AUTORIZIMI ZYRTAR - SHOQËRITË E SIGURIMEVE

Neni 29

Kërkimi i autorizimit

Autorizimi zyrtar i parashikuar në nenin 17 të këtij ligji kërkohet nga shoqëria e interesuar në këto raste:

a) Kur shoqëria dëshiron të nisë për herë të parë një veprimtari sigurimi apo një veprimtari sigurim-risigurimi.

b) Kur shoqëria e cila, në pajtim me nenin 30, ka marrë një autorizim për një grup sigurimi apo për një pjesë të rreziqeve që i përkasin atij grupi, dëshiron ta shtrijë veprimtarinë e saj në grupe të tjera sigurimi apo për rreziqe të tjera, përtej atyre për të cilat ka qenë e autorizuar.

Neni 30

Dhënia e autorizimit - rreziqet kryesore

Autorizimi zyrtar jepet për një grup sigurimesh dhe mbulon tërë grupin, përveç rastit kur shoqëria kërkon të mbulojë vetëm një pjesë të rreziqeve që i përkasin grupit të sigurimeve, siç janë listuar këto në pikën A të shtojcës së këtij ligji.

Megjithatë, ky autorizim mund të jepet edhe për disa grupe sigurimesh siç janë listuar këto në pikën B të shtojcës së këtij ligji.

Neni 31

Rreziqet aksesore - sigurimi i jetës

Shoqëria që ka marrë një autorizim për grupet e sigurimit të përcaktuara në pikat 19 dhe 21 të shtojcës së këtij ligji, mund të autorizohet të bëjë drejtpërdrejt në cilësinë e sigurimeve aksesore, sigurimeve suplementare për rreziqet e dëmtimeve trupore që përfshijnë paaftësinë për punë profesionale, vdekjen aksidentale ose invaliditetin e rrjedhur nga aksidenti apo nga sëmundja.

Neni 32

Rreziqet aksesore - sigurimi i dëmeve

Autorizimi i dhënë shoqërisë së sigurimit për një ose disa grupe sigurimi për dëme është i vlefshëm për mbulimin e rreziqeve aksesore që përfshihen në një grup tjetër në qoftë se përmbushen kushtet që vijnë:

- rreziqet aksesore të jenë të lidhura me rrezikun kryesor;
- t'u përkasin objektit që është mbuluar kundër rrezikut kryesor;
- të jenë të garantuar nga kontrata që mbulon rrezikun kryesor.

Megjithatë, rreziqet e përfshira në grupet 14 dhe 15 të pikës (a) të shtojcës së këtij ligji mund të mos konsiderohen si rreziqe aksesore të grupeve të tjera.

Neni 33

Kushtet për pajisjen me autorizim

(Shtuar pika 6 me ligjin nr. 8606, datë 27.4.2000)

Shoqëria e sigurimit mund të pajiset me autorizim zyrtar në qoftë se përmbush kushtet që vijnë:

1. Të jetë themeluar në një nga format e parashikuara në nenin 4 të këtij ligji.
2. Ta ketë kufizuar objektin e saj sipas përcaktimit në nenin 5.
3. Të ketë një program për veprimtarinë e saj të hartuar në pajtim me nenin 34.
4. Të zotërojë minimumin e fondeve të garancisë të parashikuar nga Këshilli i Ministrave në pajtim me nenin 48.
5. Drejtimi efektiv i shoqërisë t'u jetë besuar personave fizikë me kualifikim e përvojë profesionale të mjaftueshme.
6. Të japë informacion për origjinën e kapitalit. Për origjinën e kapitalit Komisioni i Mbikëqyrjes së Sigurimeve ka të drejtë të kërkojë të dhëna nga autoritetet përgjegjëse të shtetit të origjinës.

Për dhënien e autorizimit për shtrirjen e veprimtarisë sipas pikës (b) të nenit 29 shoqëria duhet të ketë një program të veprimtarisë të hartuar në pajtim me nenin 34 përse u përket grupeve të tjera të sigurimit apo rreziqeve të tjera të grupit.

Përveç kësaj shoqëria duhet të zotërojë nivelin e aftësisë paguese të parashikuar në nenin 46, dhe në qoftë se për zgjerimin e veprimtarisë kërkohet një fond minimum garancie më i lartë se më parë, ajo duhet të provojë se e zotëron këtë minimum.

Neni 34

Programi i veprimtarisë

Programi i veprimtarisë i parashikuar në pikën 3 të nenit 33 duhet të përmbajë treguesit ose justifikimet që kanë të bëjnë me:

1. Natyrën e rreziqeve që shoqëria e sigurimit parashikon të garantojë dhe kushtet e përgjithshme të policave të sigurimit që do të përdorë.
2. Tarifat që parashikon të zbatojë për çdo kategori të operacioneve.
3. Parimet drejtuese në fushën e risigurimeve.
4. Elementet që përbëjnë fondet minimum të garancisë.
5. Parashikimet për shpenzimet e ngritjes së shërbimeve administrative dhe të rrjetit të veprimtarisë sigurorese, si dhe mjetet financiare të destinuara për të përballuar këto shpenzime.

Për grupin 18 të shtojcës së këtij ligji shoqëria e sigurimit duhet të japë të dhëna për mjetet materiale dhe personelin që ve në dispozicion për t'iu përgjigjur detyrimeve ndaj të siguruarve.

6. Përveç treguesve apo justifikimeve të parashikuara në pikat 1 deri 5 më sipër, duhet të paraqiten për tre vitet e para të veprimtarisë:

- parashikimet për shpenzimet e funksionimit, të tjera nga ato të ngritjes, në veçanti shpenzimet e përgjithshme dhe ato për komisionet;
- parashikimet për primet dhe dëmshpërblimet;
- gjendjen e mundshme të likuiditeteve;
- parashikimet lidhur me mjetet financiare të destinuara për mbulimin e përgjegjësiave dhe me marzhin e aftësisë paguese.

Neni 35

Programi i veprimtarisë - të dhënat shtesë për sigurimin e jetës

Për operacionet e sigurimit që përmbajnë detyrime, zbatimi i të cilave varet nga kohëzgjatja e jetës dhe për operacionet lidhur me sigurimet aksesore të përmendura në nenin 31, shoqëria e sigurimit duhet të paraqesë në programin e veprimtarisë të dhënat shtesë që vijnë:

- a) tarifat që u përkasin rreziqeve kryesore dhe aksesore për të gjitha operacionet;
- b) baza teknike dhe metodat aktuariale të zbatuara për llogaritjen e primeve apo të kuotave, për dëmshpërblimet dhe për rezervat matematike.

Këto të dhëna duhet të jenë të nënshkruara nga docentët apo aktuarët të caktuar sipas rregullave të veçanta.

Neni 36

Publikimi i autorizimeve të dhëna

Çdo autorizim i dhënë për rastet e parashikuara në nenin 29 botohet në Fletoren Zyrtare.

Neni 37

Refuzimi i dhënies së autorizimit dhe mungesa e njoftimit

Çdo vendim për refuzim tërësor apo pjesor të kërkesës për marrje autorizimi duhet të jetë i arsyetuar dhe i njoftohet shoqërisë së interesuar nga Komisioni i Mbikëqyrjes së Sigurimeve.

Shoqëria e interesuar mund të bëjë ankim ndaj këtij vendimi, brenda një muaji nga data e marrjes njoftim, pranë gjykatës së rrethit.

Shoqëria ka të drejtën, gjithashtu t'i drejtohet ministrit të Financave për rastet kur brenda gjashtë muajve nga data e depozitimit të dosjes, rregullisht të plotësuar të kërkesës për autorizim, nuk ka marrë njoftim nga Komisioni i Mbikëqyrjes së Sigurimeve.

SEKSIONI III TËRHEQJA E AUTORIZIMIT

Neni 38

Rastet e tërheqjes së autorizimit

Autorizimi i dhënë një shoqërie sigurimesh tërhiqet nga Komisioni Mbikëqyrës i Sigurimeve kur shoqëria:

a) Nuk ka filluar veprimtarinë e sigurimit në një afat prej 12 muajsh nga data e botimit të autorizimit në Fletoren Zyrtare; ka ndërprerë veprimtarinë e saj siguruese për një kohë më shumë se gjashtë muaj, si dhe me kërkesën e saj heq dorë nga veprimtaria për të cilën ka marrë autorizimin.

b) Nuk përmbush më kushtet e parashikuara për dhënien e autorizimit.

c) Nuk ka mundur të marrë, brenda kohës së lejuar, masat e përcaktuara në programin e rimëkëmbjes financiare ose në skemën financiare sipas nenit 49.

d) Nuk përmbush seriozisht detyrimet ligjore e nënligjore subjekt i të cilave është.

Çdo vendim për tërheqjen e autorizimit duhet të mbështetet në arsye të shëndosha dhe duhet t'i njoftohet shoqërisë së interesuar.

Me marrjen e njoftimit për tërheqjen e autorizimit shoqëria nuk mund të lidhë kontrata të reja sigurimi, të ripërtërijë kontrata, të rritë shumën e sigurimit apo të zgjerojë mbulimin në sigurimin për kontratat në fuqi.

Neni 39

Mbrojtja e personave të siguruar

Në rast të tërheqjes së autorizimit Komisioni i Mbikëqyrjes së Sigurimeve duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme për të mbrojtur interesat e personave të siguruar dhe në veçanti duhet të kufizojë përdorimin e lirë të pasurive të shoqërisë në përputhje me nenin 44.

Neni 40

Publikimi

Vendimi për tërheqjen e autorizimit zyrtar dhënë një shoqërie sigurimi, botohet në Fletoren Zyrtare.

SEKSIONI IV REZERVAT TEKNIKE DHE MBULIMI I TYRE

Neni 41

Krijimi i rezervave

Në pajtim me natyrën e operacioneve të sigurimit dhe të risigurimit që kryen, çdo shoqëri duhet të krijojë rezerva teknike të mjaftueshme për të gjithë veprimtarinë e saj.

Rezervat teknike krijohen përpara se të nxirret rezultati i çdo ushtrimi financiar.

Neni 42

Mbulimi i provizioneve

Rezervat teknike duhet të jenë të mbuluara me pasuri të llojeve të ndryshme dhe

ekuivalente me përgjegjësitë financiare të kontraktuara përsa i përket shumës dhe llojit të monedhës.

Pasuritë në mbulimin e rezervave teknike duhet të gjenden në territorin e Republikës së Shqipërisë. Megjithatë Komisioni i Mbikëqyrjes mund të autorizojë vendosjen e pjesëve të kësaj pasurie jashtë këtij territori në rastet kur një gjë e tillë është e justifikuar nga mënyra e mbulimit të përgjegjësisë të kontraktuara nga shoqëria.

Pasuritë në mbulim të rezervave teknike që gjenden në formën e kërkesave debitore konsiderohen të vendosura në shtetin ku ato do të realizohen.

Neni 43

Përbërja e pasurisë në mbulim të rezervave teknike

Pasuria në mbulim të rezervave teknike duhet të ketë një përbërje të përshtatshme në mënyrë që të sigurohet ruajtja e vlerës, efektshmëria si dhe tregtueshmëria apo realizimi me lehtësi i saj.

Në përshtatje me llojet e sigurimeve apo të risigurimeve që kryhen shoqëria mund të mbulojë rezervat teknike me kategoritë e pasurive që vijojnë:

1. Investime:

a) letra me vlerë debitore afatshkurtër të emetuara ose të garantuara nga shteti, aksione dhe letra me vlerë të ngjashme me aksionet, si dhe obligacione të blera me një qëllim afatshkurtër;

b) kredi të dhëna kundrejt hipotekave;

c) aksione dhe pjesëmarrje të tjera produktive të zotëruara me qëllim afatgjatë;

ç) toka, ndërtesa dhe e drejta mbi prona të patundshme;

d) mjete të tjera të tregjeve të parasë dhe të kapitalit;

2. Kërkesa debitore dhe kërkesa për dëmshpërblime.

a) shuma që detyrohen risiguresit, përfshirë pjesën e risigurimeve në rezervat teknike;

b) depozitat në shoqëritë ceduese së Sigurimeve dhe shuma të tjera që detyrohen ato;

c) shuma që detyrohen policmbajtësit, si dhe ndërmjetësit në operacionet siguruese dhe risiguruese;

ç) kërkesat që rrjedhin nga rastet e shpëtimit dhe të subregimit;

d) shumat për t'u kthyer nga taksat;

dh) kërkesa të tjera debitore.

3. Të tjera:

a) para në bankë dhe në arkë, depozita në institucionet e kreditit dhe në çdo organizëm tjetër të autorizuar për depozita;

b) interesat dhe qiratë e maturuara, të ardhura të tjera të maturuara dhe parapagesat;

c) pasuri të patundshme të tjera, përveç atyre të përcaktuara në pikën 1/ç më sipër.

Neni 44

Ndalimi i përdorimit të lirë të pasurive

Në qoftë se shoqëria nuk u përmbahet parashikimeve të neneve 41, 42 dhe 43, Komisioni i Mbikëqyrjes së Sigurimeve mund të ndalojë përdorimin e lirë të pasurive të shoqërisë pasi t'i ketë komunikuar arsyen e një mase të tillë.

Komisioni i Mbikëqyrjes së Sigurimeve mund të marrë në këtë rast çdo masë tjetër të domosdoshme që ka për qëllim mbrojtjen e interesave të personave të siguruar, nënshkrues apo përfitues të kontratave të sigurimit.

Neni 45
Akte të zbatimit

Për zbatimin e dispozitave të këtij seksioni ministri i Financave vendos rregulla më të hollësishme. Në mënyrë të veçantë ai përcakton:

- rregullat për llogaritjen e rezervave teknike për sigurimet e jetës dhe për sigurimet e dëmeve;
- llojet konkrete të pasurive që shoqëria e sigurimeve dhe/ose risigurimit mund të përdorë për mbulimin e rezervave teknike, brenda kategorive të përcaktuara në nenin 43;
- kufijtë maksimalë për investimin e pasurive në mbulim të rezervave teknike sipas kategorive të investimeve dhe sipas organizmave, tregut dhe objekteve ku investohet;
- rregullat për vlerësimin e pasurive në mbulim të rezervave teknike;
- kushtet e garancive të mjaftueshme për investimet e shoqërive të sigurimit dhe/ose risigurimit.

SEKSIONI V
AFTËSIA PAGUESE

Neni 46
Marzhi i aftësisë paguese

Çdo shoqëri dhe/ose risigurimi duhet të krijojë një marzh aftësie paguese të mjaftueshëm për të gjithë veprimtarinë e saj.

Marzhi i aftësisë paguese i përgjigjet vlerës së pasurive të shoqërisë, të lirë nga çdo detyrim ose përgjegjësi e parashikuar dhe pas zbritjes së elementeve të patrupëzuara. Ai përfshin pikërisht:

- kapitalin themelor të derdhur;
- gjysmën e kapitalit themeltar të paderdhur;
- rezervat e detyrueshme dhe të lira që nuk i korrespondojnë përgjegjësive të mbuluara;
- fitimet e mbartura;
- kërkesën dhe vërtetimin nga ana e shoqërisë të çdo plusvlere të fshehur, që ka ardhur nga nënvlerësimi i pasurive, me kusht që plusvlerat e fshehura të mos kenë karakter përjashtimor.

Ministri i Financave, në bazë të propozimit ose të marrjes së mendimit të Komisionit të Mbikëqyrjes së Sigurimeve, mund të përcaktojë me udhëzim elemente të tjera që përfshihen në marzhin e aftësisë paguese.

Neni 47
Niveli i kërkuar i marzhit të aftësisë paguese

Niveli i kërkuar i marzhit të aftësisë paguese përcaktohet në varësi të natyrës së operacioneve të sigurimit dhe të risigurimit që kryen një shoqëri sigurimi dhe/ose risigurimi.

Bazat mbi të cilat llogaritet niveli i kërkuar i marzhit të aftësisë paguese, si dhe metodat e llogaritjes përcaktohen me udhëzim të ministrit të Financave.

Neni 48
Fondi i garancisë

Fondi i garancisë është sa një e treta e nivelit të kërkuar të aftësisë paguese. Megjithatë, ky fond nuk mund të jetë më i vogël se kufijtë minimalë të caktuar me vendim të Këshillit të

Ministrave.

Neni 49

Rimëkëmbja financiare

Në qoftë se niveli i marzhit të aftësisë paguese të shoqërisë ka rënë nën nivelin minimum të kërkuar sipas nenit 47, Komisioni i Mbikëqyrjes së Sigurimeve i kërkon shoqërisë të paraqesë për miratim një plan afatgjatë për rivendosjen e një gjendjeje financiare të qëndrueshme.

Në qoftë se niveli i marzhit të aftësisë paguese të shoqërisë bie nën minimumin e fondit të garancisë të përcaktuar sipas nenit 48, Komisioni i Mbikëqyrjes i kërkon shoqërisë që të paraqesë për miratim një skemë financimi afatshkurtër.

Komisioni i Mbikëqyrjes së Sigurimeve, gjithashtu, mund të vendosë masat e parashikuara në nenin 44 kur çmon se gjendja financiare e shoqërisë do të keqësohet më tej.

SEKSIONI VI

DISPOZITA PËR KONTABILITETIN DHE GJENDJEN FINANCIARE

Neni 50

Mbajtja e kontabilitetit

Shoqëritë e sigurimit dhe/ose të risigurimit duhet të mbajnë një kontabilitet të rregullt në pajtim me dispozitat e ligjit nr.7661, datë 19.1.1993 "Për kontabilitetin" dhe me dispozitat e Planit Kontabël të Sigurimeve.

Neni 51

Gjendja financiare

Shoqëritë e sigurimit dhe/ose të risigurimit duhet të përgatitin gjendjet financiare vjetore sipas strukturës dhe përmbajtjes së përcaktuar në planin kontabël për sigurimet.

Me përjashtim të pamundësisë të njohur nga Komisioni i Mbikëqyrjes së Sigurimeve ushtrimi kontabël për të cilin përgatiten gjendjet financiare fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor të çdo viti. Përjashtimisht, ushtrimi i parë kontabël i shoqërive që fillojnë veprimtarinë e tyre në gjashtëmujorin e dytë të vitit mund të mbyllet në mbarim të vitit pasardhës.

Neni 52

Llogaridhënia e detajuar

Shoqëritë e sigurimit dhe/ose të risigurimit duhet t'i paraqesin Komisionit të Mbikëqyrjes së Sigurimit një llogaridhënie vjetore të detajuar të operacioneve të tyre dhe të gjitha gjendjet, tabelat ose dokumentet që mundësojnë të kontrollohet gjendja financiare e tyre, ecuria e operacioneve, arkëtimi i primeve ose i kuotave, pagimi i dëmshpërblimeve, vlerësimi dhe mbulimi i rezervave.

Lista dhe forma e dokumenteve të llogaridhënies vjetore, si dhe afatet e paraqitjes caktohen me udhëzim të ministrit të Financave.

SEKSIONI VII

TRANSFERIMI I PORTOFOLIT

Neni 53

Procedura

Shoqëritë e sigurimit që i nënshtrohen këtij ligji mundet që me autorizimin e Komisionit të Mbikëqyrjes të transferojnë te një ose disa shoqëri të tjera të autorizuar tërësinë ose një pjesë të portofolit të tyre të kontratave me të gjitha të drejtat dhe detyrimet.

Kërkesa për transferim u bëhet e ditur kreditorëve me një lajmërim të botuar në Fletoren Zyrtare duke u lënë afat për tre muaj për të paraqitur vërejtjet.

Të siguruarit kanë një afat prej një muaji nga data e botimit të këtij lajmërimi në Fletoren Zyrtare për të zgjidhur kontratat e tyre. Me këtë rezervë, Komisioni i Mbikëqyrjes së Sigurimeve miraton transferimin në qoftë se çmon se transferimi është në pajtim me interesat e kreditorëve dhe të të siguarve.

Neni 54

Niveli i marzhit të aftësisë paguese të shoqërisë marrëse

Komisioni i Mbikëqyrjes së Sigurimeve merr vendim për transferimin e portofolit të parashikuara në nenin 53, në qoftë se shoqëria marrëse zotëron, duke marrë parasysh transferimin, një nivel të marzhit të aftësisë paguese të paktën të barabartë me shumën e kërkuar.

Neni 55

Shoqëritë e sigurimit të jetës - transferimi i portofolit

Aktivitetet e transferuara me një portofol kontratash nga një shoqëri e sigurimit të jetës caktohen në një seksion kontabël të veçantë të shoqërisë marrëse të kontratave.

Neni 56

Transferimi zyrtar i portofolit

Kur Komisioni i Mbikëqyrjes së Sigurimeve në zbatim të nenit 89 vendos t'i imponojë shoqërisë transferimin zyrtar të portofolit të saj të kontratave të sigurimit, ky vendim i bëhet i ditur të gjitha shoqërive të sigurimit nëpërmjet një lajmërimi në Fletoren Zyrtare. Brenda një muaji nga data e botimit të këtij lajmërimi shoqëritë që pranojnë të marrin në ngarkim portofolin në fjalë duhet të njoftojnë Komisionin e Mbikëqyrjes së Sigurimeve.

Shoqëria e caktuar nga Komisioni i Mbikëqyrjes së Sigurimeve për të marrë në ngarkim portofolin e kontratave të sigurimit, objekt transferimi, njoftohet për këtë me letër rekomande me kërkesën për marrje njoftimi.

Vendimi që shpall transferimin cakton mënyrat dhe datën e hyrjes në fuqi.

SEKSIONI VIII

BASHKIMI DHE NDARJA

Neni 57

Bashkimi ose ndarja me transferim e portofolit

Kur operacionet e bashkimit ose të ndarjes të përmendura në nenin 243 të ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare" përmbajnë transferime të portofolit të kontratave me kushtet e parashikuara në nenin 53 të këtij ligji, atëherë dispozitat e neneve 255 dhe 259 (paragafi i dytë) të ligjit "Për shoqëritë tregtare" nuk janë të zbatueshme.

Neni 58

Bashkimi ose ndarja pa transferim e portofolit

Me rezervën e dispozitave të nenit 59 të këtij ligji, për operacionet e bashkimit dhe të ndarjes që nuk përmbajnë transferim të portofolit janë të zbatueshme dispozitat e ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare".

Neni 59

Kundërshtimi i bashkimit ose i ndarjes

Kur operacionet e bashkimit ose të ndarjes nuk përmbajnë transferime të portofolit të këtij ligji, të kryera në kushtet e parashikuara në nenin 53, shoqëritë e sigurimit duhet t'i paraqesin Komisionit të Mbikëqyrjes së Sigurimeve një deklaratë të shoqëruar me të gjitha dokumentet e nevojshme që të tregojnë qëllimet dhe mënyrat e realizimit të operacionit të projektuar. Këto dokumente duhet të paraqiten të paktën një muaj përpara se të realizohet operacioni. Gjatë kësaj kohe Komisioni i Mbikëqyrjes së Sigurimeve mund ta kundërshtojë operacionin kur gjykon se nuk është në pajtim me interesat e të siguruarve apo të kreditorëve ose operacioni do të kishte rrjedhojë të zvogëlonte vlerën e shitjes së investimeve që u përgjigjen përgjegjësisë ndaj të siguruarve. Komisioni i Mbikëqyrjes së Sigurimeve mund, gjithashtu, të kërkojë dokumente plotësuese të nevojshme për vlerësimin e operacionit.

SEKSIONI IX

LIKUIDIMI

Neni 60

Kushtet e zbatimit të ligjeve të tjera

Likuidimi i shoqërive të sigurimit dhe/ose risigurimit kryhet në pajtim me dispozitat e ligjit "Për shoqëritë tregtare" dhe të ligjit "Për procedurat e falimentimit", përveç rasteve kur në këtë ligj përcaktohet ndryshe.

Neni 61

Efektet e tërheqjes së autorizimit - likuidimi

Vendimi i Komisionit të Mbikëqyrjes së Sigurimeve që shpall tërheqjen tërësore të autorizimit zyrtar, sjell automatikisht prishjen e Shoqërisë së Sigurimit.

Neni 62

Pushimi i efekteve të kontratave: sigurimi i dëmeve

Në rastin e tërheqjes së autorizimit zyrtar të dhënë një shoqërie sigurimi, të gjitha kontratat e nënshkruara për sigurimin e dëmeve pushojnë së pasuri efekt, ditën e dyzetë në mesditë, nga data e botimit në Fletoren Zyrtare të vendimit për tërheqjen e autorizimit. Primet ose kuotizacionet e maturuara para datës të këtij vendimi dhe të papaguara në këtë datë i detyrohen për totalin e tyre shoqërisë, por arkëtohen nga kjo përpjestimisht me periudhën e garancisë deri në datën e zgjidhjes së kontratës. Primet ose kuotizacionet që maturohen midis datës së vendimit dhe datës së zgjidhjes përfundimtare të kontratës detyrohen përpjestimisht me periudhën e garancisë.

Megjithatë, përsa u përket kontratave të sigurimit detar një vendim i Këshillit të Ministrave cakton kushtet në të cilat mund të bëhet shmangie nga dispozitat e paragrafit të parë.

Neni 63

Pushimi i efekteve të kontratave - sigurimi i jetës

Pas botimit në Fletoren Zyrtare të vendimit për tërheqjen e autorizimit zyrtar, kontratat për sigurimin e jetës, të nënshkruara nga shoqëritë e sigurimit, mbeten të rregulluara nga kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të tyre, sa kohë që nuk është shpallur vendimi i ministrit të Financave, i parashikuar në paragrafin e dytë. Likuidatori mundet që me autorizim të Komisionit të Mbikëqyrjes së Sigurimeve, të shtyjë pagesat për fatkeqësitë, afatet dhe vlerat e riblerjes. Primet e arkëtuara nga likuidatori derdhen në një llogari të posaçme.

Komisioni i Mbikëqyrjes së Sigurimeve me kërkesën e likuidatorit dhe në bazë të raportit të gjykatës kontrolluese mund t'i propozojë ministrit të Financave të caktojë me vendim datën në të cilën kontratat shfuqizohen, të autorizojë transferimin e tyre, tërësisht ose pjesërisht të një ose disa shoqëri të tjera, të zgjasë afatin e tyre, të vendosë zvogëlimin e shumave të pagueshme në rast jete ose vdekje, si dhe masa të tjera me qëllim që vlera e përgjegjësisë të shoqërisë të arrijë në shumën që mund të mbulohet nga gjendja e likuidimit.

Neni 64

Pavlerësia e operacioneve pas tërheqjes së autorizimit

Me kërkesën e Komisionit të Mbikëqyrjes së Sigurimeve, Gjykata mund të shpallë pavlerësinë e një ose të shumë operacioneve të kryera nga drejtuesit e një shoqërie të pajisur me një likuidator, si rrjedhojë e tërheqjes së autorizimit zyrtar. Komisioni i Mbikëqyrjes së Sigurimeve është i ngarkuar të sjellë prova që vërtetojnë se personat që kanë kontraktuar me shoqërinë e dinin që aktiviteti ishte i pamjaftueshëm për të garantuar kreditë e privileguara të të siguruarve dhe që operacioni do të kishte si rrjedhojë të zvogëlonte këtë garanci.

KREU III

DISPOZITAT PËR SHOQËRITË E HUAJA

SEKSIONI I

AUTORIZIMI ZYRTAR

Neni 65

Autorizimi zyrtar

(Ndryshuar shkronja "a" me ligjin nr. 8606, datë 27.4.2000)

Shoqëritë e sigurimit me seli në një shtet të huaj, të cilat kërkojnë të ushtrojnë veprimtari sigurimi në pajtim të paragrafit 2 të nenit 4 të këtij ligji, mund të pajisen me autorizim zyrtar të parashikuar nga neni 18, në qoftë se u përgjigjen kushteve që vijnë:

a) të jenë të pajisura me zotësinë për të kryer operacione sigurimi, në mbështetje të legjislacionit të shtetit të origjinës dhe të kenë ushtruar veprimtari të paktën prej 5 vjetësh;

b) të krijojnë degën e saj për të kryer operacionet e parashikuara në Republikën e Shqipërisë;

c) të marrë përsipër të mbajë në qendër të kësaj dege një kontabilitet të veçantë për veprimtarinë që ushtron, si dhe të ruajë aty të gjitha dokumentet që lidhen me këtë veprimtari;

ç) të caktojë një përfaqësues të përgjithshëm në pajtim me nenin 66;

d) të vendosë në Republikën e Shqipërisë pasuri me një vlerë të barabartë të paktën me gjysmën e fondit minimal të garancisë të parashikuar në nenin 48 dhe të depozitojë një të

katërtën e këtij minimumi në cilësinë e dorëzarisë, të kthyeshme në rastet e mosmarrjes të autorizimit;

dh) të marrë përsipër për të zotëruar nivelin e marzhit të aftësisë paguese në pajtim me nenin 47;

e) të paraqesë një program të veprimtarisë në pajtim me nenin 33.

Për dhënien apo refuzimin e autorizimit zyrtar një shoqërie të huaj janë të zbatueshme nenet 29, 30, 31, 32, 36, 37 të këtij ligji.

Neni 66

Përfaqësuesi i përgjithshëm

Përfaqësuesi i përgjithshëm i parashikuar në pikën c të nenit 65 duhet të pajiset me një autorizim të posaçëm që përmban pranimin e tij. Ky autorizim jepet nga ministri i Financave.

Përfaqësuesi i përgjithshëm duhet të ketë vendbanim dhe të banojë efektivisht në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Ai duhet të ketë kualifikimin ose përvojën profesionale të mjaftueshme.

Përfaqësuesi i përgjithshëm duhet të ketë fuqi të mjaftueshme për të angazhuar shoqërinë ndaj të tretëve dhe për ta përfaqësuar atë në marrëdhëniet me organet shtetërore dhe me gjykatat shqiptare.

Në rast se përfaqësuesi i përgjithshëm është një person juridik ai duhet të caktojë një person fizik për ta përfaqësuar atë, duke i dhënë të gjitha fuqitë e nevojshme për këtë qëllim.

Neni 67

Gjuha shqipe

Kërkesa për marrjen e autorizimit dhe të të gjitha dokumenteve që e shoqërojnë atë duhet të paraqitet në gjuhën shqipe ose e përkthyer në shqip.

SEKSIONI II

DISPOZITAT PËR FINANCAT

Neni 68

Rezervat teknike

Shoqëritë e sigurimit me seli në një shtet të huaj duhet të krijojnë rezerva teknike të mjaftueshme që u përgjigjen përgjegjësi të kontraktuara në territorin e Republikës së Shqipërisë. Ato duhet të sigurojnë që rezervat teknike janë krijuar nga Dega dhe janë të mbuluara nga pasuri ekuivalente e të lokalizuara në Republikën e Shqipërisë.

Për rezervat teknike dhe pasuritë në mbulim të këtyre provizioneve janë të zbatueshme dispozitat e neneve 41, 42 dhe 43 të këtij ligji.

Neni 69

Niveli i marzhit të aftësisë paguese

Degët e shoqërive të huaja duhet të zotërojnë një marzh të aftësisë paguese të përbërë nga vlera të pasurisë së çliruar nga çdo detyrim ose përgjegjësi e parashikueshme dhe duke zbritur elementet e patrupëzuara. Niveli i marzhit të aftësisë paguese llogaritet në pajtim me nenin 47. Megjithatë, për llogaritjen e këtij niveli, primet ose kuotat dhe shpenzimet për dëmet merren në masën që rezultojnë nga operacionet e kryera nga dega e shoqërisë së huaj në Republikën e Shqipërisë.

Pasuritë që përfaqësojnë nivelin e marzhit të aftësisë paguese duhet të jenë të lokalizuara në Republikën e Shqipërisë të paktën deri në masën e fondit të garancisë.

Neni 70

Fondi i garancisë

Fondi i garancisë është sa një e treta e nivelit të aftësisë paguese. Ky fond nuk mund të jetë më i vogël se gjysma e minimumit të përcaktuar nga Këshilli i Ministrave në pajtim me nenin 48. Në këtë shumë përfshihet edhe dorëzania fillestare e derdhur në pajtim me pikën (d) të nenit 65.

Neni 71

Mosrespektimi i dispozitave për rezervat

Në qoftë se dega e shoqërisë së huaj nuk i përmbahet dispozitave të këtij ligji për rezervat teknike dhe pasuritë në mbulim të tyre, si dhe dispozitave për marzhin e aftësisë paguese dhe për fondin e garancisë, Komisioni i Mbikëqyrjes së Sigurimeve mund të vendosë masat e parashikuara në nenin 44 dhe 49 të këtij ligji.

Arsyeja e vendosjes së masave i komunikohet gjithashtu shoqërisë nga varet dega që ushtron veprimtari në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 72

Tërheqja e autorizimit

Autorizimi i dhënë shoqërisë së huaj mund të tërhiqet në të gjitha rastet e parashikuara në nenin 38 të këtij ligji.

Autorizimi i dhënë shoqërisë së huaj tërhiqet gjithashtu kur kësaj shoqërie i është tërhequr autorizimi përkatës në shtetin ku është regjistruar. Në këtë rast shoqëria duhet të njoftojë Komisionin e Mbikëqyrjes së Sigurimit brenda 15 ditëve nga data e tërheqjes së autorizimit në shtetin e saj.

Neni 73

Efektet e tërheqjes së autorizimit

Vendimi i Komisionit të Mbikëqyrjes së Sigurimeve që shpall tërheqjen tërësore të autorizimit zyrtar sjell automatikisht, nga data e publikimit në Fletoren Zyrtare, likuidimin e aktivitetit dhe të pasivit të bilancit të Degës për veprimtarinë e ushtruar në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 74

Gjendjet financiare dhe llogaridhënia vjetore

Në bazë të të dhënave të kontabilitetit të mbajtur për veprimtarinë e ushtruar në Republikën e Shqipërisë dhe të inventarit, dega e shoqërisë së huaj përgatit dhe depoziton në organin kompetent të caktuar gjendjet financiare vjetore që idërgon shoqërisë së vendit të origjinës.

Për ushtrimin kontabël që mbulojnë gjendjet financiare vjetore janë të zbatueshme dispozitat e paragrafit të dytë të nenit 51.

Degët e shoqërive të huaja duhet t'i paraqitin Komisionit të Mbikëqyrjes së Sigurimeve një llogaridhënie vjetore të hollësishme të hartuar në pajtim me nenin 52.

KREU IV
MBIKËQYRJA

SEKSIONI I
KOMISIONI I MBIKËQYRJES

Neni 75
Krijimi i Komisionit

Për ushtrimin e mbikëqyrjes së parashikuar në këtë ligj krijohet Komisioni i Mbikëqyrjes së Sigurimeve.

Ky Komision gëzon personalitet juridik.

Selia e Komisionit të Mbikëqyrjes së Sigurimeve vendoset në Tiranë.

Neni 76
Funksionimi

Rregullat mbi mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Komisionit të Mbikëqyrjes së Sigurimeve caktohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 77
Personeli dhe emërimet

Komisioni i Mbikëqyrjes së Sigurimeve përbëhet nga një kryetar, dy zëvendëskryetarë dhe katër anëtarë.

Kryetari i Komisionit të Mbikëqyrjes së Sigurimeve emërohet nga Këshilli i Ministrave.

Zëvendëskryetarët dhe anëtarët e Komisionit të Mbikëqyrjes së Sigurimeve emërohen nga ministri i Financave me propozim të kryetarit të Komisionit të Mbikëqyrjes së Sigurimeve. Të paktën një nga anëtarët e Komisionit të Mbikëqyrjes së Sigurimeve duhet të jetë aktuar.

Personeli profesional i Komisionit të Mbikëqyrjes së Sigurimeve përbëhet nga inspektorët kontrollues, që emërohen nga kryetari i Komisionit të Mbikëqyrjes së Sigurimeve, në bazë të një testimi profesional të organizuar sipas rregullave të caktuara nga vetë komisioni.

Neni 78
Përballimi i shpenzimeve - buxheti

Buxheti i shpenzimeve të Komisionit të Mbikëqyrjes së Sigurimeve miratohet në total nga ministri i Financave i cili cakton, gjithashtu, edhe pjesën e kontributeve për financimin e këtyre shpenzimeve.

Neni 79
Sekreti profesional

Drejtuesit dhe personeli teknik i Komisionit të Mbikëqyrjes së Sigurimeve janë të detyruar të ruajnë sekretin profesional. Ky sekret nuk u kundërvihet autoriteteve gjyqësore.

Neni 80
Kërkimi i informacionit

Komisioni i Mbikëqyrjes së Sigurimeve mund t'u kërkojë ekspertëve kontabël të

autorizuar të shoqërive të sigurimeve dhe/ose të risigurimeve çdo informacion mbi veprimtarinë e shoqërisë. Ekspertët kontabël të autorizuar janë të çliruar nga sekreti profesional ndaj këtij komisioni.

Neni 81

Këmbimi i informacionit me organizma të tjerë vendas

Komisioni i Mbikëqyrjes së Sigurimeve dhe organizmave të tjerë që kontrollojnë bursat, tregun financiar, konkurrencën dhe investimet financiare, pa hequr dorë nga respektimi i dispozitave të kundërta, mund të këmbejë informacione të nevojshme për përmbushjen e misioneve të tyre përkatëse.

Informacionet e marra në këtë rrugë u nënshtrohen rregullave të sekretit profesional në organizmin që i jep.

Neni 82

Dhënia e informacionit autoriteteve mbikëqyrëse të huaja

Komisioni i Mbikëqyrjes së Sigurimeve mund t'u japë informacione autoriteteve të ngarkuara me mbikëqyrjen e sigurimeve në vendet e tjera, me rezervën e reciprocitetit dhe me kusht që këto autoritete t'i nënshtrohen sekretit profesional me të njëjta garanci si në Republikën e Shqipërisë.

SEKSIONI II USHTRIMI I KONTROLLIT

Neni 83

Format e kontrollit

Kontrolli i shoqërive të sigurimit dhe/ose të risigurimit kryhet mbi dokumente dhe në vend. Organizimi dhe mënyrat e kryerjes së kontrollit caktohen nga Komisioni i Mbikëqyrjes së Sigurimeve.

Neni 84

Kërkimi i informatave dhe dokumenteve

Komisioni i Mbikëqyrjes së Sigurimeve u kërkon shoqërive të sigurimit dhe/ose të risigurimit çdo informacion dhe dokument që ai e çmon të nevojshëm për ushtrimin e kontrollit.

Neni 85

Verifikimi i publikimeve

Komisioni i Mbikëqyrjes së Sigurimeve verifikon që publikimet e detyrueshme të shoqërive të sigurimit të kryhen rregullisht. Ai mund të urdhërojë shoqëritë përkatëse që të bëjnë publikime ratifikuese në rastet kur konstatohen pasaktësi ose harresa. Komisioni mund të informojë publikun për çdo gjë që gjykon të nevojshme.

Neni 86

Shtrirja e kontrollit

Nëse është dhe për aq sa është e nevojshme Komisioni i Mbikëqyrjes së Sigurimeve

mund të vendosë për shtrirjen e kontrollit në të gjitha shoqëritë në të cilat shoqëria që është objekt i kontrollit zotëron, drejtpërdrejt ose tërthorazi, më shumë se gjysmën e kapitalit ose të votave. Ky kontroll mund të shtrihet, gjithashtu, në organizmat e çdo natyre që kanë lidhur me shoqërinë e sigurimit dhe/ose të risigurimit, drejtpërdrejt ose tërthorazi, një marrëveshje që mund të ndryshojë pavarësinë apo vendimet lidhur me një nga fushat e veprimtarisë së shoqërisë.

Shtrirja e kontrollit mund të ketë si objekt vetëm verifikimin e gjendjes financiare të shoqërisë së sigurimit dhe/ose të risigurimit të kontrolluar, si dhe respektimin nga kjo shoqëri të përgjegjësive që ka kontraktuar ndaj të siguruarve ose përfituesve të kontratave të sigurimit dhe të risigurimit.

Neni 87

Kontrolli në vend - raporti kontradiktor

Në rastin e një kontrolli në vend inspektori kontrollues përgatit një raport. Në qoftë se raporti përmban vërejtje, këto i bëhen të njohura shoqërisë së kontrolluar. Komisioni merr dijeni për vërejtjet e inspektoriatit ose të inspektorëve dhe për përgjigjet e sjella nga shoqëria. Përgjigjet e shoqërisë duhet të jepen pikë për pikë sipas vërejtjeve të raportit.

Rezultatet e kontrollit në vend i komunikohen qoftë Këshillit Administrativ, qoftë drejtorisë dhe Këshillit të Mbikëqyrjes së Shoqërisë së Kontrolluar. Ato i njoftohen, gjithashtu, ekspertëve kontabël të autorizuar të shoqërisë së kontrolluar.

Neni 88

Paralajmërimi - urdhërimi

Kur një shoqëri siguri dhe/ose risiguri shkel një dispozitë ligjore dhe nënligjore të fushës së kontrollit nga Komisioni i Mbikëqyrjes së Sigurimeve, ose ka një sjellje që vë në rrezik nivelin e aftësisë pague apo zbatimin e përgjegjësive që ajo ka kontraktuar, mund t'i adresojë një paralajmërim.

Komisioni mundet, gjithashtu, t'i dërgojë shoqërisë një urdhër me qëllim që të marrë brenda një afati të caktuar çdo masë për të rivendosur ose forcuar ekuilibrin financiar apo të korrigjojë praktikën e saj.

SEKSIONI III

SANKSIONET DISIPLINORE DHE FINANCIARE QË VENDOSEN NGA KOMISIONI I MBIKËQYRJES

Neni 89

Sanksionet

Kur një shoqëri vendase apo një degë e shoqërisë së huaj ka shkelur një dispozitë ligjore ose nënligjore të fushës së kontrollit nga Komisioni i Mbikëqyrjes së Sigurimeve, ose nuk ka përfituar një urdhërim të tij të bërë sipas nenit 77, Komisioni mund të vendosë ndaj shoqërisë ose ndaj drejtuesve të saj një ose disa nga sanksionet disiplinore që vijnë në varësi të rëndësisë së shkeljes:

1. Ndalimin për të kryer disa operacione dhe çdo kufizim tjetër në ushtrimin e veprimtarisë.

2. pezullimin e përkohshëm të një ose disa drejtuesve të shoqërisë.

3. Tërheqjen pjesore ose tërësore të autorizimit.

4. Transferimin zyrtarisht të një pjese ose të të gjithë portofolit të kontratave.

Përveç kësaj komisioni mund të vendosë, qoftë në vend të sanksioneve të mësipërme, qoftë mbi ato, një gjobë. Shuma e kësaj gjobe duhet të jetë në varësi të rëndësisë së shkeljeve të lejuara, por pa kaluar 3 për qind të shumës së primeve të ralizuara gjatë ushtrimit të fundit të mbyllur, të llogaritur për 12 muaj. Ky maksimum mund të shkojë deri në 5 për qind në rast të një shkeljeje të re të njëjtë detyrim ligjor apo nënligjor. Shumat përkatëse derdhen në buxhetin e shtetit. Ato arkëtohen si detyrime ndaj shtetit.

Në të gjitha rastet e parshikuara më sipër komisioni vendos në pajtim me rregullat e caktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 90

Njoftimi i vendimit

Vendimi i Komisionit të Mbikëqyrjes së Sigurimeve që përmban një nga saksionet e përmendura në nenin 89, i njoftohet shoqërisë përkatëse brenda 8 ditëve nga data e marrjes së tij, me letër rekomande me kthim përgjigje për marrjen njoftim.

Neni 91

Ankimet kundër vendimit

Shoqëria ose personi ndaj të cilit është vendosur një sanksion disiplinor apo gjobë me vendim të Komisionit të Mbikëqyrjes së Sigurimeve mund të bëjë ankim te ministri i Financave brenda 10 ditëve nga data e marrjes njoftim për vendimin.

Ministri i Financave duhet të vendosë në një afat prej 30 ditësh.

Shoqëria mund të bëjë ankim ndaj vendimit të Komisionit të Mbikëqyrjes së Sigurimeve pranë gjykatës së rrethit brenda 15 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për vendimin ose, në rastin kur i është drejtuar ministrit të Financave, brenda 10 ditëve nga data e kalimit të afatit të vendosjes nga ky i fundit.

Neni 92

Publikimi i vendimit

Kur një sanksion disiplinor ose gjobë vendosur nga Komisioni i Mbikëqyrjes së Sigurimeve është bërë përfundimtar Komisioni mundet, me shpenzimet e shoqërisë, të urdhërojë publikimin e vendimit në tre gazeta dhe afishimin në vende të caktuara dhe për një kohë të caktuar.

KREU V

DISPOZITA TË PËRKOHSHME

Neni 93

Për sa kohë që nuk do të jetë themeluar një shoqëri e veçantë për sigurimin e jetës, ministri i Financave, në shmangie të nenit 6 të këtij ligji, mund të autorizojë, për grupe të caktuara, kryerjen nga e njëjta shoqëri të dy llojeve të sigurimeve. Në këtë rast shoqëria e sigurimit detyrohet të mbajë llogari të veçantë për sigurimin e jetës, të administrojë veças fondet e pagesat për këtë sigurim dhe të përcaktojë veças rezultatet përfundimtare të tij.

Neni 94

Hyrja në fuqi e ligjit

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 1434, datë 28.3.1996 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.

SHTOJCË E LIGJIT NR.8081, DATË 7.3.1996

A. Klasifikimi i rreziqeve në përputhje me grupet e sigurimeve.

Sigurimet për dëme

1. Aksident (përfshirë plagosjet industriale dhe sëmundjet e profesionit)

a) të ardhura fikse financiare

b) të ardhura në formën e dëmshpërblimit

c) kombinimi i të dyjave

ç) persona të transportuar

2. Sëmundjet

a) të ardhura fikse financiare

b) të ardhura në formën e dëmshpërblimit

c) kombinimi i të dyjave

3. Mjete tokësore (të ndryshme nga ato që lëvizin mbi shina)

Të gjitha dëmtimet ose humbjet nga

a) mjetet tokësore automotorike

b) mjetet tokësore joautomotorike

4. Mjetet lëvizëse mbi shina

- të gjitha dëmet ose humbjet nga mjetet lëvizëse mbi shina

5. Avionët

- të gjitha dëmet ose humbjet e pësuar nga mjetet ajrore

6. Anijet (detare, liqenore, lumore dhe të kanaleve) të gjitha dëmet ose humbjet e pësuar nga:

a) anijet lumore dhe të kanaleve

b) anijet e liqeneve

c) anijet detare

7. Mallrat në transport (përfshirë mallra, bagazhe dhe të gjitha llojet e tjera të sendeve)

Të gjitha dëmtimet ose humbjet e mallrave gjatë tranzitimit ose bagazhet pavarësisht nga mënyra e transportit.

8. Zjarri dhe forcat e natyrës

Të gjitha dëmtimet ose humbjet e sendeve (të ndryshme nga ato të përfshira në pikat 3, 4, 5, 6 dhe 7) të shkaktuara nga:

a) zjarret

b) shpërthimet

c) stuhitë

ç) forcat e natyrës të ndryshme nga stuhia

d) energjia nukleare

dh) shkarja e tokës

9. Dëmtime të tjera të pasurisë

Të gjitha dëmtimet ose humbjet në pasuri (por jo ato që përfshihen në pikat 3, 4, 5, 6 dhe 7) kur dëmi është shkaktuar nga breshëri ose ngrica dhe çdo ngjarje të tillë si vjedhja, të ndryshme nga ato të përmendura në pikën 8).

10. Përgjegjësitë civile nga përdorimi i automjeteve

Të gjitha përgjegjësitë që lindin nga përdorimi i automjeteve mbi tokë (përfshirë

përgjegjësitë e transportuesit).

11. Përgjegjësitë civile nga përdorimi i avionëve

Të gjitha përgjegjësitë që lindin nga përdorimi i avionëve (përfshirë përgjegjësitë e transportuesit).

12. Përgjegjësitë civile për anijet (detare, të liqeneve dhe lumenjve si dhe ato të kanaleve)

Të gjitha përgjegjësitë që lindin nga përdorimi i anijeve ose barkave (anije të vogla që lundrojnë në det, liqene, lumenj dhe kanale lundrimi duke përfshirë përgjegjësitë e transportuesit).

13. Përgjegjësitë civile të përgjithshme

Të gjitha përgjegjësitë përveç atyre të përmendura në nr.10, 11 dhe 12.

14. Krediti

a) paaftësia paguese e përgjithshme

b) kreditë e eksportit

c) kreditë me këste

ç) kreditë hipotekare

d) krediti bujqësor

15. Garancitë

- garancitë e drejtpërdrejta

- garancitë e tërthorta

16. Humbje të ndryshme financiare

a) rreziqet e punësimit

b) pamjaftueshmëria e të ardhurave (e përgjithshme)

c) moti i keq

ç) humbja e të ardhurave

d) shpenzimet e përgjithshme të vazhdueshme

dh) shpenzimet tregtare të paparashikuara

e) humbja e vlerës së tregut

ë) humbja nga qiratë ose të ardhurat

f) humbja drejtpërdrejt nga tregtimi, ndryshe nga ato të përmendura më sipër

g) humbje financiare jotregtare

gj) të tjera humbje financiare

17. Mbrojtja ligjore

Shpenzimet ligjore dhe ato të mosmarrëveshjeve

18. Asisetenca (ndihma)

Asistenca (ndihma) personave në vështirësi, pikërisht gjatë udhëtimeve.

Sigurimi për jetën

19. Jetë - vdekje

Çdo operacion që përmban përgjegjësi, zbatimi i të cilit varet nga zgjatja e jetës së njeriut.

20. Martesë - lindje

Çdo operacion që ka për objekt derdhjen e një kapitali në rast martesë ose të lindjes së fëmijëve.

21. Sigurime të lidhura me fonde të investimeve

Çdo operacion që përmban angazhime, ekzekutimi i të cilave varet nga zgjatja e jetës së njeriut dhe e lidhur me një fond investimi.

22. Administrimi i fondeve kolektive

Çdo operacion që konsiston në administrimin e investimeve dhe pikërisht të aktiveve që përfaqësojnë rezerva të shoqërive të ndryshme, përveç atyre të sigurimit dhe/ose risigurimit, dhe që paguajnë të ardhura në rast jete, në rast vdekjeje ose në rast të zvogëlimit të veprimtarisë

së njeriut.

B. Përshkrimi i autorizimeve të dhëna për më shumë sesa një grup sigurimesh

Kur autorizimi mbulon njëkohësisht:

- a) Grupet nr.1 dhe 2 do të emërtohen "Sigurim i aksidenteve dhe shëndetit".
- b) Grupet nr.1 (paragrafi i katërt), 3, 7 dhe 10, do të emërtohen "Sigurime motorike".
- c) Grupet nr.1 (paragrafi i katërt) 4, 6, 7 dhe 12 do të emërtohen "Sigurimi i marinës dhe i transportit".
- ç) Grupet nr.1 (paragrafi i katërt), 5, 7 dhe 11 do të emërtohen "Sigurimi i avionëve".
- d) Grupet nr.8 dhe 9 do të emërtohen "Sigurimi nga zjarri dhe dëmtime të tjera në pronë".
- dh) Grupet nr.10, 11, 12 dhe 13 do të emërtohen "Sigurimi i përgjegjësive".
- e) Grupet nr.14 dhe 15 do të emërtohen "Sigurimi i kreditit dhe i garancisë".
- ë) Grupet 19, 21, 22 do të emërtohen "Sigurimi i jetës".